



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
Fakulteti Ekonomik

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Dekani
Prof. Asoc. Dr. Halil KUKAJ

Nr. i ref. 01/920

Prizren, më 11.12.2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

FAKULTETIT EKONOMIK

dhe

Fabrika konditorike "LIRI"

E lidhur më datë: 11.12.2019 ndërmjet:

FAKULTETIT EKONOMIK DHE FABRIKA KONDITORIKE "LIRI"

Universiteti i Prizrenit "Ukshin HOTI" rr." Shkronjave" nr. 1 Prizren

Përfaqësuar nga Dekani: Prof. Asoc. Dr. Halil KUKAJ

(Tani e tutje do tu referohemi si "Palë")

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (në tekstin e mëtejme Marrëveshje) e lidhur në mes Fabrikës konditorike "LIRI" dhe Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin HOTI" Prizren e cila ka të bëjë me mbajtjen e praktikës profesionale të studentëve të Fakultetit Ekonomik.

Neni 2

Fakultetit Ekonomik i Universitetit "Ukshin HOTI" në Prizreni ka drejtimet si më poshtë ku studentët kanë nevojë për mbajtjen e praktikës profesionale në organizatën tuaj.

Nr.	Fakulteti	Drejtimi	Programi	
1.	Ekonomik	Menaxhment Ndërkombëtar	Bachelor	
		Administrim Biznesi	Bachelor	
		Kontabilitet dhe Auditim	Master	
		Administrim Biznesi	Master	

Fabrikës konditorike "LIRI" është e obliguar që studentëve të Fakultetit Ekonomik të Universitetit "Ukshin HOTI" Prizren tu ofrojë kushte për mbajtjen e praktikës profesionale në afat prej 15 ditë.

Neni 4

Studentëve që studiojnë në programet e lartshënuara fakulteti është i obliguar që për studentët që kanë arritur me i dhanë provimet e nevojshme dhe që duhet të mbajnë praktikën profesionale t'i sistemoj dhe tu jap dokument zyrtar se ata mund të vazhdojnë praktikën në ndërmarrjen e lartshënuar për periudhën e caktuara kohore prej 15 ditë pune gjegjësisht në afat prej 60 orë.

Neni 5

Ndërmarrja është e obliguar që studenteve praktikant tu krijojë kushte dhe ambient pune që studentet e Fakultetit Ekonomik të mund të ushtrojnë profesionin e tyre për kohën sa janë në praktikë në ndërmarrjen e lartë cekur.

Neni 6

Ndërmarrja është e obliguar që pas përfundimit të praktikës studenteve tu japin vërtetim me shkrim se kanë mbajtur praktikën profesionale në periudhën e caktuar në organizatën e tyre.

Neni 7

Ndërmarrjet sipas nevojave dhe kërkesave mund të angazhojnë pedagogë të fakultetit Ekonomik për kryejnë e ekspertizave profesionale. Kushtet e bashkëpunimit për ekspertiza do të definohen me kontratë.

Neni 8

Marrëveshja ka afat vlefshmërie për periudhe tre vjeçare të bashkëpunimit me mundësi vazhdimi edhe për periudha tjera kohore.

Neni 8

Marrëveshja e bashkëpunimit është e nënshkruar në 2 kopje identike në gjuhën shqipe.

Të gjitha kopjet kanë të njëjtën force ligjore dhe janë të vlefshme për të gjitha palët nënshkruese.

Kjo marrëveshje hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Dekani:

Prof. Asoc. Dr. Halil KUKAJ

Përfunduar nga:

Drejtori/ Menaxheri:

Arben TËRSHINAKRI

Prizren, 2019